



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 592/11 Prot.

Tiranë, më 13.05.2024

VENDIM

Nr. 22 datë 13/05/2024

MBI

**“MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR 1 (NJË) NDRYSHIM NË RREGULLOREN  
“PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DREJTUESE DHE  
SENATIN AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, gërma (d), të Statutit të Universitetit të Arteve, neni 24, pika 1, gërma (g), të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me VSA nr. 17, datë 29.03.2024, të shkresës nr. 592 prot., datë 03.05.2024 të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve në UART, me lëndë “Propozime për ndryshime në Rreguloren e Zgjedhjeve 2024” (bashkëngjitur), pas shqyrtimit dhe diskutimeve, Senati Akademik i Universitetit të Arteve,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit për ndryshimin e pikës 11, të nenit 4 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Arteve”, si më poshtë:

**“Kur ndërmjet dy ose më shumë kandidatëve në garë për postin e një autoriteti drejtues, numri i votave të vlefshme është i barabartë, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike pas zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë. Nëse edhe pas raundit të dytë ka barazi votash të vlefshme, zgjedhja për autoritet drejtues bëhet me short. Shorti organizohet dhe zhvillohet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, pranë zyrës së tij, në prani të palëve të interesuara.**

2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca si dhe t’i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.




**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**


Prof. Kastriot ÇAUSHI



Prof. Najada HAMZAJ



Prof. Dr. Isak SHEHU



Prof. Ilir MARTINI



Prof. Artan PEQINI



Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)



Prof. Arben LLOZI




Prof. Asoc. Dr. Artan IBËRSHIMI



Prof. Asoc. Dorian ÇENE



Prof. Gazmend GJOKA



Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA



Prof. Dr. Erald BAKALLI



Prof. Endri SINA



Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI



Prof. Asoc. Albes FUSHA




Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI



Prof. Asoc. Genci FUGA



Erlind FUSHA (Student FAB)



Sindi ZDRAVA (Studente FM)



Për Komitetin

*[Signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 592 prot.

Tiranë, më 03.05.2024

Lënda: Propozime për ndryshime në Rregulloren e Zgjedhjeve 2024

SENATIT AKADEMIK,  
UNIVERSITETI I ARTEVE

Të nderuar Anëtarë,

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) të Universitetit të Arteve, pas një procesi të gjatë konsultimi dhe diskutimi, propozon që në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve", të miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 17, datë 29.03.2024, në pikën 11 të nenit 4 me titull "Parime të përgjithshme", të bëhen ndryshimet si në vijim të kësaj shkrese, pasi gjykojmë se parashikimi aktual krijon hapësirë për keqinterpretime.

Pika 11 e nenit 4 të Rregullores parashikon "Kur asnjëri prej dy a më shumë kandidatëve në garë për postin e një autoriteti drejtues nuk arrin të sigurojë shumicën e votave të vlefshme, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike pas zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë. Nëse edhe pas raundit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk arrin të sigurojë shumicën, zgjedhja për autoritet drejtues bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve".

Mendojmë që shprehja "shumicën e votave të vlefshme" do ta vështirësonte shpalljen e fituesit, në rastin kur për postin e një autoriteti drejtues konkurrojnë 3 (tre) ose më shumë kandidatë. Me shumicë të votave do të kuptohet 50%+1 e votave të vlefshme të të gjithë kandidatëve. Pavarësisht se njëri prej kandidatëve do të fitonte numrin më të madh të votave të vlefshme, nëse atij do t'i kërkohej edhe plotësimi i kushtit për arritjen e shumicës së thjeshtë, vlerësojmë se në disa raste, kjo do të rezultonte në një pengesë të panevojshme për shpalljen e fituesit.

Ndërkohë, mendojmë se në fakt kjo pikë e rregullores i referohet rastit kur ndërmjet kandidatëve do të rezultonte barazi votash. Kjo vjen si rrjedhojë e faktit që nuk mund të ketë një raund të dytë apo short kur ndërmjet kandidatëve nuk ka patur barazi. Gjykojmë se mënyra se si rasti i barazisë



Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al





së votave është shprehur në pikën 11 të Rregullores krijon hapësirë për keqinterpretim, referuar rastit hipotetik që morëm më sipër, ndaj propozojmë riformulimin e saj.

Propozojmë që pika 11, e nenit 4 të Rregullores të ndryshohet në: *“Kur ndërmjet dy ose më shumë kandidatëve në garë për postin e një autoriteti drejtues, numri i votave të vlefshme është i barabartë, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike pas zgjedhjeve zhvillohet një raund i dytë. Nëse edhe pas raundit të dytë ka barazi votash të vlefshme, zgjedhja për autoritet drejtues bëhet me short. Shorti organizohet dhe zhvillohet nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, pranë zyrës së tij, në prani të paleve të interesuara.*

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Orges Malaj

Kryetar



Shpëtim Kërçova

Suela Agolli

Adela Kusuri


Sara Caca

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar



Redjan Mulla

Sekretar



